



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

GJIMNAZI I GJUHËVE



Prishtinë, qershor 2008

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë pa e shkarra vitur jashtë, shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo fragmentin e mëposhtëm të përbërë nga dy paragrafë dhe përgjigju pyetjeve nga 1 deri në 21.

I.

Dola jashtë qytetit, përtej Urës së Bahçallekut. Fillova me recitue: *“Përmbi lumë të Babilonit, atje ndejem dhe lotueme, kah na shkonte malli i Sionit”*. Ecëshem i vetmuem. U mendojshem me e shpejtue hapin, që të mos më xajë nata në rrugë. Por nata mue më kishte xanë, nata e mendjes. Un nuk dijshe ma se kah me ia mbajtë. Ku jam? Ku shkoj? Aty? Atje? Ku? Ç’do të baj?

E ndjeva vedin se nuk ishem kurrëgjja tjetër por një tullumbac në hava që sillet në atë drejtim që ta çojë era. E shka asht era? A thue asht vetë jeta? Trishtim i madh! O zot, rri me ne se asht kah erret!

II.

E kupton? Ti ke ardhë këtu në kohën ma t’keqe që ka pas Katolicizmi ndonjiherë e sidomos na. Ktheu në katund, aty ku ishe, struku, mos fol, as mos i beso as këmishës sate. Na kemi nevojë për ty që të jetojsh e jo me dekë. Na pleqtë edhe në ardhhtë puna me dekë, e kemi kositë livadhin, por ju të rijs duhet të jetoni. Zoti asht i Madh. I kjosim fal atij të lumit që ka krijue vdekjen, se për ndryshej njerzit do t’kishin me kenë skllav të tiranve. Edhe kta do t’desin një ditë, e ti duhesh t’jetojsh vetëm sa me tregue. Kurrëgjja në mos kjos i zoti me ba rrno vetëm për me tregue. A e kupton shka po du me t’thanë? Mbaruen të tjerët, mbarojmë na, mbaron edhe ti: të gjithë shkojnë si qeni në rrush po nuk kje dikush me kallxue si kje puna. Kush te teproj le të kallxojë! Nuk asht fjala që po mbarojmë sot. E dijmë këtë. Nuk duhet të mbarojmë për nesër e për shekujt e ardhshëm. E kupton këtë? Fra Zef un jam sot për sot Superjor: po ta jap urdhër: Ik rrno! Vetëm për me tregue!

At Zef Pllumi
(Rrno vetëm për me tregue)

1. Paragrafi i parë i tekstit është:

- A. ese;
- B. reportazh;
- C. prozë poetike;
- D. fragment drame.

2. Togfjalëshi: „e kemi kositë livadhin”, në paragrafin e dytë, e ka kuptimin:

- A. kemi punuar shumë deri tash;
- B. e kemi jetuar pjesën më të madhe të jetës;
- C. duhet të pushojmë tash e tutje;
- D. gjithë jetën kemi punuar kot së koti.

3. Në paragrafin e parë, **informacioni themelor** nga del motoja: „*O zot, rri me ne se asht kah erret!*” është:
- A. Por nata mue më kishte xanë, nata e mendjes. Un nuk dijshe ma se kah me ia mbajtë;
 - B. U mendojshe me e shpejtue hapin, që të mos më xajë nata në rrugë;
 - C. E ndjeva vedin se nuk ishem kurrëgj tjetër por një tullumbac në hava që sillet në atë drejtim që ta çojë era;
 - D. Dola jashtë qytetit, përtej Urës së Bahçallekut.
4. Në paragrafin e dytë, fjalia: „... *mos fol, as mos i beso as këmishës sate*” shpreh ndjenjën e:
- A. inferioritetit;
 - B. epërsisë;
 - C. mosbesimit;
 - D. miqësisë.
5. Fjala te paragrafi i dytë: „*Kush të teproj le të kallxojë!*”, ka kuptimin:
- A. kush tregon do te shpëtojë;
 - B. kush nuk shpëton s’ka çka tregon;
 - C. kush e tepron duhet të tregojë;
 - D. kushdo që mbetet gjallë le të tregojë.
6. Fjala: „*rrno*” e ka kuptimin:
- A. qëndro;
 - B. jeto;
 - C. rrëno;
 - D. mendo
7. Në paragrafin e parë, fjalia: „*Un nuk dijshe ma se kah me ia mbajtë*” mbështetet në:
- A. gjendjen personale – psikologjike;
 - B. të dhënat historike- kombëtare;
 - C. gjendjen sociale-politike;
 - D. analizën gazetareske të gjendjes.
8. Në paragrafin e dytë, fjalia: „*I kjoshim fal atij të lumit që ka krijue vdekjen*”, në shqipen standarde bën:
- A. I qofshim falë atij të lumit që ka krijue vdekjen;
 - B. I qofshim fal atij të lumit që ka kriju vdekjen;
 - C. I qofshim fal atij të lumit që ka krijua vdekjen;
 - D. I qofshim falë atij të lumit që ka krijuar vdekjen.

9. Paragrafi i parë i këtij teksti i përmbahet bisedës në **vetën e**:
- A. parë shumës;
 - B. parë njëjës;
 - C. dytë shumës;
 - D. dytë njëjës.
10. **Titulli më i përshtatshëm** për paragrafin e parë do të ishte:
- A. Fillova me recitue;
 - B. Mbi lumë të Babilonit;
 - C. Nata e mendjes;
 - D. Kah me ia mbajtë.
11. Cila është **pozita e narratorit** në paragrafin e parë?
- A. autori narrator;
 - B. e zhvendosur;
 - C. retrospektive;
 - D. perspektive.
12. **Gjuha e përdorur** në të dy paragrafët është:
- A. letrare;
 - B. gegërishte,
 - C. toskërishte;
 - D. çamërishte.
13. Cili **diskurs** mbizotëron në paragrafin e parë?
- A. historik;
 - B. heroik;
 - C. personal;
 - D. jopersonal.
14. Fjala: „*ecëshem*” në fjalinë „*Ecëshem i vetmuem*”, të paragrafit të parë, në **shqipen standarde** bën:
- A. ecja;
 - B. ecëshim;
 - C. ecnim;
 - D. ecsha.
15. **Tema qendrore** e këtij teksti ka të bëjë me:
- A. artin;
 - B. ideologjinë;
 - C. letërsinë;
 - D. kulturën.

16. Përfundimi i këtij teksti është se **personazhi** duhej të ikte:

- A. për ta shpëtuar familjen e tij;
- B. për të mos i dëmtuar miqtë e tij;
- C. për të ndenjmur në katundin e tij;
- D. për të dëshmuar për atë kohë.

17. Në fund të fjalisë: „*Jeto vetëm për të treguar*” , **duhet të vihet:**

- A. pikëpresja;
- B. pikëpyetja;
- C. pikë çuditësja;
- D. dy pikat.

18. Folja *jetoj* në mënyrën dëshirore, koha e tashme, veta e tretë njëjës, në formën veprorë bën:

- A. jetoj;
- B. jetuakam;
- C. jetofsha;
- D. jetoftë.

19. Periudha: „*I kjoshim fal atij të lumit që ka krijuar vdekjen, se për ndryshej njerzit do t’kishin me kenë skllav të tiranve*” në paragrafin e dytë është:

- A. e bashkërenditur;
- B. e nënrenditur;
- C. pyetëse;
- D. habitore.

20. Konstrukti: „*Vetëm për me tregue*” , e paragrafit të dytë është:

- A. togfjalësh leksikor;
- B. fjali mohore;
- C. fjali pohore;
- D. togfjalësh frazeologjik.

21. Fjala *tiran* në shumës bën:

- A. tiran;
- B. tirani;
- C. tiranet;
- D. tiranë.

Lexo poezinë e mëposhtme pastaj përgjigju pyetjeve nga 22 deri në 28.

KUSH JE TI?

Kush je ti? Sfidë e shekujve,
grusht i tiranëve, tmerr i mbretërve.
Lirinë kërkon. Pushka s'ka çark.
Fluturimin do e krahët s'i hap.
Me raso je veshur, zotin tall.
Kush je ti? Perëndi a djall?

Herë Bethoven, herë Kajam.
Nuk e di kur qesh, nuk e di kur qan.
Ofeli e ëmbël, korb qe te tremb,
të dhemb kaq shumë e s'di ç'të dhemb.
Hamlet i ngrysur, Sanço hokatar,
gjysmë asket, gjysmë mëkatar.

Herë urrejtje, herë dashuri.
Kush je ti? Zjarr apo hi?
Zhurmën e pëlqen, heshtjes i flet,
gjysma lolo, gjysma mbret.
Këmbët në Boston, zemrën në Ballkan.
Njëri sy të qesh, tjetri sy të qan.

Duart të ngrijnë, zjarrin s'e ndez.
Lumenjtë i pi e etja të djeg.
Heshtje e shurdhër, gjëmim hata.
Kush je ti, kush je ti, pra?
Oh, po pas dilemës u fshehka gjeniu,
brenda një loti ndritka njeriu.

Kështu ngjitesh e zbret shekujve;
sfidë e harrimit, tmerr i mbretërve,
zjarr që përvëlon, kallkan acar.
Kush je ti? NOLI shqiptar!

(Bardhyl Londo)

22. Forma e kësaj poezie është:

- A. sonet;
- B. varg i matur;
- C. akrostik;
- D. varg i lirë.

23. Në vargjet: *Heshtje e shurdhër, gjëmim hata.*

Kush je ti, kush je ti pra?

rima është:

- A. e mbyllur;
- B. e alternuar;
- C. e puthur;
- D. e hapur.

24. Në vargun: *kështu ngjitesh e zbret shekujve*

Sfidë e harrimit tmerr i mbretërve,

mbizotëron:

- A. aliteracioni;
- B. asonanca;
- C. simploka;
- D. anadiploza.

25. Forma e shkrimit të figurshëm, si në fjalinë: „*Ofeli e ëmbël, korb që të tremb*”, është tipike për:

- A. tekste letrare;
- B. tekste gazetareske;
- C. fjalime politike;
- D. dokumente zyrtare.

26. Folja *u fshehka* është në diatezën:

- A. veprare;
- B. pësore;
- C. mesore;
- D. vetvetore.

27. Vargu: „*gjysma lolo, gjysma mbret*” interpretohet si:

- A. lavdërim ndaj prijësve;
- B. respekt ndaj revolucionarëve;
- C. përqeshje ndaj qeveritarëve;
- D. mitizim i sundimtarëve.

28. Në këtë tekst poetik autori e identifikon poetin Fan Noli me Hamletin e Shekspirit.

Këtë e bën **për faktin** se Noli:

- A. kishte fat të njëjtë me atë të Hamletit;
- B. dëshironte të identifikohet me Hamletin;
- C. e kishte pasur mik personal Hamletin;
- D. ishte përkthyes i tragjedisë Hamleti.

Lexo tekstin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjeve nga 29 deri në 40

I.

Fëmijët i porosit ta duan vendin dhe gjuhën tonë gjer në vuajtje. Të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë, as kur do të vuajnë pa faj. Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret. Këtu kanë lindur, këtu të rrojnë me mish e shpirt, qoftë edhe me dhembje.

II.

Profesionizmi në letërsi, në vendin tonë është hë për hë, një rrugë vuajtjesh, buka e tij është e hidhur. E hidhur, them, për atë që s' di marifete dhe hipokrizia. Terreni i letërsisë është një tokë ku gëlojnë gjarpërinjtë. Të vrasin shokët, se u bën hije. Dhe kur nuk u bën hije do të thotë se nuk je i zoti për letërsi.

III.

Dorëshkrimet ua lë atyre të dyve, sidomos Pandeliut. Të mos i prek askush! Ay do të rritet, do të lexojë shënimet e porealizuara, do t'i përpunojë. Për këtë duhet të grumbullojë më parë shumë kulturë. Talenti, prirja nuk vlejnë asgjë pa punë, pa kulturë.

Askush të mos i prek dorëshkrimet para se të më rritet djali! I vini në arkë, i mbyllni!"

Mitrush Kuteli
(Testamenti, 1965)

29. Fjalët “**talenti, prirja**” janë:

- A. antonime;
- B. homonime;
- C. sinonime;
- D. patronime.

30. Autori: „*Fëmijët i porosit ta duan vendin dhe gjuhën tonë gjer në vuajtje*” pasi që:

- A. Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret;
- B. Talenti, prirja nuk vlejnë asgjë pa punë, pa kulturë;
- C. Profesionizmi në letërsi është një rrugë vuajtjesh;
- D. Për këtë duhet të grumbullojë më parë shumë kulturë..

31. Cila fjali paraqet **informatë themelore** në paragrafin e dytë?

- A. Askush të mos i prek dorëshkrimet para se të më rritet djali;
- B. Profesionalizmi në letërsi, në vendin tonë është një rrugë vuajtjesh;
- C. Ay do të rritet, do të lexojë shënimet e porealizuara, do t'i përpunojë;
- D. Të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë, as kur do të vuajnë pa faj.

32. Sipas tekstit del se në **terrenin e letërsisë** kishte:

- A. solidaritet;
- B. konkurrencë;
- C. lojalitet;
- D. hipokrizi.

33. Fjala: „Ay”, në fjalinë „Ay do të rritet, do të lexojë shënimet e perealizuar, do t'i përpunojë” ka kuptimin:

- A. ty;
- B. ai;
- C. aty;
- D. ti.

34. Fjalët: „vrrarë, gëlojnë, rritet”, në gramatikë janë:

- A. folje;
- B. ndajfolje;
- C. emra;
- D. mbiemra.

35. Fjala **hipokrizi** në fjalinë: „ E hidhur, them, për atë që s' di marifete dhe hipokrizira” e ka kuptimin e:

- A. smirës dhe inatit ;
- B. lojës dhe humorit;
- C. misterit dhe prapavijës;
- D. mashtrimit dhe dyfytërisë.

36. Shenja e pikësimit ! në fund të fjalisë: „I vini në arkë, i mbyllni!” është:

- A. apostrof;
- B. pikëpyetje;
- C. pikë çuditëse ;
- D. pikëpresje.

37. Testamenti është rrëfim intim për:

- A. shokët dhe porosi për miqtë e tij;
- B. familjarët dhe porosi për fëmijët;
- C. lexuesit dhe porosi për masat e gjera;
- D. prindërit dhe porosi për të parët e tij.

38. Fjalja: „Terreni i letërsisë është një tokë ku gëlojnë gjarpërinjtë” ka kuptimin:

- A. autori mund të bjerë viktimë e shkrimeve të veta
- B. në letërsi lëvizin figura dhe personazhe negative;
- C. letërsinë e kësaj kohe e vlerësonin njerëzit profesionist;
- D. të merreshe me letërsi ishte kënaqësi e vërtetë.

39. Në **tekstin** e mësipërm kemi të bëjmë me kohë:

- A. të mira për letërsinë;
- B. të vështira për letërsinë;
- C. kur vlerësohet letërsia e mirëfilltë;
- D. kur lartësohet letërsia e mirëfilltë.

40. Letërsia e cila ndiqet, **përbëhet nga shteti** është:

- A. letërsi e braktisur;
- B. letërsi e përfillur;
- C. letërsi e anatemuar;
- D. letërsi e dirigjuar.

ENGLISH LANGUAGE

41. Choose the correct alternative to complete the following sentence:

That night the ground started to shake exactly at 12 p.m. It started to shake _____.

- A. in the middle of the night.
- B. during the night.
- C. after midnight.
- D. at midnight.

42. You are going to travel long distance and are considering the most convenient means of transport. Look at the table below and choose the correct answer:

Means of transport	advantages	Disadvantages
Car	Takes you wherever you want to go, cheap,	Traffic jams, not safe, cannot read, sleep, cannot watch the world go by
Train	No traffic jams, fast, comfortable, can read, watch the world go by	Expensive, crowded, cannot take you door to door
Bus	Cheap, can read, sleep, watch the world go by	Not very comfortable, blocked roads, speed limit, cannot walk or stand
Ship	Comfortable, luxurious, cheap, can socialize, relax, make the most of it	Takes too long, makes you seasick, dangerous if you can't swim
Airplane	Fast, comfortable, can read, sleep, eat	Very expensive, dangerous, need a taxi or bus to airport

- A. One cannot sleep or read or see the world go by while travelling by bus.
- B. Travelling by airplane you can see the world around you all the time.
- C. Train takes you wherever you want to go and stops at the point you want.
- D. As far as safety conditions are concerned cars are as dangerous as airplanes.

43. Read the following sentences:

1. The story is about a remote village in the middle of nowhere.
2. But one day he disappears with no trace and everything goes wrong.
3. Everybody is happy until a stranger comes to village to sick his fortune.
4. It is the most exciting book I have ever read.
5. He makes a plan to build a large factory and employ many villagers.

The correct order of sentences to form a dialogue is:

- A. 4 1 3 5 2
- B. 4 5 2 1 2
- C. 3 2 1 5 4
- D. 1 2 3 4 5

44. Choose a word to complete the following sentence:

'This is indeed a very nice room' 'Yes, but I must _____ it by the end of this month.'

- A. abandon
- B. vacate
- C. leave
- D. evacuate

45. Read the following sentences and then choose a sentence to complete the dialogue:

Barbara: I wanted to tell you the truth but you wouldn't listen.

Shirley: _____ . I know the whole story.

- A. It's no bother!
- B. Don't trouble!
- C. Don't bother!
- D. It's no trouble!

46. In the following dialogue:

George: Did you buy that house?

Steven: I didn't. I couldn't get _____ .

from the following expressions:

1. pocket money
2. mortgage
3. allowance
4. grant

Steven should say, '**the mortgage**' because _____.

- A. this is the money he should have in the house when he buys it.
- B. this is the money he should have in his pocket when he buys a house.
- C. this is the money he borrows when he buys a house and doesn't pay back.
- D. this is the money he borrows when he buys a house and has to pay back.

47. Choose the correct answer to complete the sentence:

In the world of animals _____ is considered the king.

- A. lion
- B. a lion
- C. the lion
- D. that lion

48. The sentence 'By this time next week we will have finished our work.' is in the _____.

- A. Future continuous tense
- B. Future perfect tense
- C. Present perfect tense
- D. Past perfect tense

49. Look at the following nouns. One of these words **DOES NOT** exist. Which one?

- A. solemnity
- B. celebrity
- C. tranquility
- D. accountility

50. Choose the best way to join the following sentences:

Pamela had worked very hard all summer.

She didn't pass her final examination.

- A. Although Pamela had worked very hard all summer, she didn't pass **her** examination.
- B. Since Pamela had worked very hard all summer, she didn't pass her examination.
- C. Pamela had worked very hard all summer and she didn't pass her examination.
- D. Pamela had worked very hard all summer so she didn't pass her examination.

51. Choose the correct sentence:

- A. Because I applied for that new job a friend of mine recommended it to me.
- B. I applied because for that new job a friend of mine recommended it to me.
- C. I applied that new job for because a friend of mine recommended it to me.
- D. I applied for that new job because a friend of mine recommended it to me.

52. Look at the words in the box:

people - what – think – think - you – do - these – world – rest - the – the – of – of

The correct combination to form a question is:

- A. What do you think these people think of the rest of the world?
- B. What do these people think you of the rest of the world think?
- C. What the rest of the world think do you think of these people?
- D. What these people do think of the rest of the world think you?

53. Which word is different?

- A. bring
- B. swing
- C. wing
- D. cling

54. Choose the correct word to complete the following sentences:

The book had a happy _____.

I would like to _____ this argument.

- A. finish
- B. end
- C. start
- D. begin

55. In the words given below the **underlined letter(s)** is pronounced in the same way **EXCEPT** in one. Which one?

- A. enough
- B. though
- C. tough
- D. rough

56. In the string of words: **wet, rain, dry, cloudy, windy** the word **rain** is different because _____.

- A. it's an adjective
- B. it denotes weather conditions
- C. it doesn't denote weather conditions
- D. it is a noun

57. Read the paragraph carefully:

Now Scotland needs a goal for a draw. **They need two goals for a win.** Can they do it? MacLeish has got the ball for Scotland. Listen to the crowd! They live the little striker from Glasgow rangers! MacLeish is going past Brown...Brown can't stop him. MacFarlane is on his right, MacPherson is on his left... MacFarlane wants the ball. But MacLeish isn't going to give it to him. The goalkeeper is coming towards him...he's going past the goalkeeper...and that's it. It's there! It's a draw! The referee is blowing his whistle. That's the end of the game!

Look at the highlighted sentence and complete the following sentence:

The commentator _____.

- A. is convinced that they will win.
- B. thinks that that they will win.
- C. calculates the winning score.
- D. considers that that they should win.

58. The advertisement: 'Closing down sale. Everything must go.' means:

- A. Everything is on sale.
- B. The shop is closed.
- C. Everyone must go in.
- D. Everything is sold.

59. This holiday is celebrated worldwide. It always falls at the end of the month of December. It is related with presents, a tree... This holiday is _____.

- A. New Year
- B. Christmas
- C. Thanksgiving
- D. Easter

60. Read the following paragraph:

Ginger's expenditure is stable. Her monthly course fee is 95€, the bus fare is 24€, the flat rent is not very high; however 320€ is a lot of money for a student. Apart from this she usually spends other 200€ for food. Not counting clothes, books, wireless connection expenses, going out with friends and similar, her monthly expenses are _____.


- A. six hundred and ninety-four Euros
- B. five hundred and ninety-four Euros
- C. six hundred and thirty-nine Euros
- D. seven hundred and thirty-nine Euros

MATEMATIKË

61. Është dhënë figura


Cila nga shprehjet vijuese paraqet syprinën e figurës?

- A. $cd + af$
- B. $ab - ed$
- C. $bc + fe$
- D. $ac - ed$



62. Sipas grafikut të funksionit të dhënë në figurë, sa është $f(0) + f(2)$?

- A. 0
- B. 1
- C. 2
- D. 3



63. Laura në ditën e parë të muajit mars shpenzoi 2€, ditën e dytën shpenzoi 4€, ditën e tretë 6€ e kështu me radhë. Cili pohim është i saktë për shumën e parave që shpenzoi Laura nga dita e parë e marsit, deri më 12 mars?

- A. më pak se 138€
- B. ndërmjet 138 € dhe 148€
- C. ndërmjet 148 € dhe 158€
- D. më shumë se 158€

64. Në qoftë se vlen $x^3 + y^3 = 28$ dhe $x^2 - xy + y^2 = 7$, atëherë sa është vlera e $x + y$?


- A. 3
- B. 4
- C. 5
- D. 6

65. Sa është vlera shprehjes numerike komplekse: $A = (\sqrt{1+i} + \sqrt{1-i})^2$, ku $i^2 = -1$?

- A. $A = 0$
- B. $A = 1$
- C. $A = 2 - 2\sqrt{2}$
- D. $A = 2 + 2\sqrt{2}$

66. Cili ekuacion kuadratik i përgjigjet gjetjes së x sipas të dhënave në figurë?

- A. $x^2 + 6x - 55 = 0$
- B. $x^2 + 6x + 55 = 0$
- C. $x^2 - 6x - 55 = 0$
- D. $x^2 - 6x + 55 = 0$



67. Pagesat e punonjësve në një kompani jepen në tabelën e mëposhtme. Sa është paga mesatare në kompani?

- A. 237 €
- B. 247 €
- C. 257 €
- D. 267 €

Pagesa	Merret prej
210€	2 teknikësh
380 €	1 inxhinieri
240€	6 punëtorësh
430€	1 menaxheri

68. Janë paraqitur tri figura të formuara prej trekëndeshave.

Cila formulë i përgjigjet numrit të trekëndeshave (të vegjël) të figurës së n -të nëse kështu vazhdohet ndërtimi i tyre?

- A. n
- B. n^2
- C. $n+1$
- D. $n^2 + 1$



Figura 1



Figura 2



Figura 3

69. Në një shportë ka më pak se 100 mollë. Mollët mund të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet 2, 3 ose 5 fëmijësh, por jo ndërmjet 4 fëmijësh. Sa mollë ka në shportë?

- A. 6
- B. 15
- C. 30
- D. 60

70. Me cilën shprehje është ekuivalente shprehja $(3^{-2} \cdot \sqrt{3})^2$?

- A. 27
- B. $\frac{1}{27}$
- C. 81
- D. $\frac{1}{81}$

HISTORI

71. Cila nga shtresat shoqërore në Athinën e lashtë përfaqësonte shtresën aristokrate ?

- A. Demos
- B. Metek
- C. Eupatridë
- D. Aeropag

72. Cilat shtete themeluan Bllokun e Antantës?

- A. Anglia, Franca, Rusia
- B. Greqia, Italia, Shqipëria
- C. Turqia, Holanda, Belgjika
- D. Spanja, Portugalia, Suedia

73. Cilat ishin dallimet në politikën e jashtme të Teodor Ruzveltit dhe të Adolf Hitlerit ?

- A. Teodor Ruzvelt ishte përkrahës i politikës agresive ndaj fqinjëve ,ndërsa Adolf Hitleri ishte për revidimin e vendimeve të Paqes së Lozanës
- B. Teodor Ruzvelt nuk ishte përkrahës i politikës agresive ndaj fqinjëve, ndërsa Adolf Hitleri ishte për revidimin e vendimeve të Paqes së Versajës
- C. Teodor Ruzvelt ishte përkrahës i politikës agresive ndaj fqinjëve ,ndërsa Adolf Hitleri ishte për revidimin e vendimeve të Paqes së Versajës
- D. Teodor Ruzvelt nuk ishte përkrahës i politikës agresive ndaj fqinjëve ,ndërsa Adolf Hitleri ishte për respektimin e vendimeve të Paqes së Versajës

74. Cili ishte qëllimi i reformave të Solonit?

- A. Përfaqësimi i interesave të aristokracisë si dhe anulimi i borxheve
- B. Përfaqësimi i interesave të aristokracisë si dhe anulimin e skllavërisë
- C. Ngritja e mirëqenies dhe aftësisë mbrojtëse të Athinës
- D. Ngritja e mirëqenies dhe aftësisë mbrojtëse të Spartës

75. Çfarë vendimesh mori Konferenca e Prizrenit e vitit 1945 ?

- A. Të zbatohen vendimet e Konferencës së Bujanit
- B. Kosova me viset tjera shqiptare t'i bashkohet shtetit amë
- C. Të formohet Federata e shteteve Ballkanike
- D. Të anulohen vendimet e Konferencës së Bujanit

76. Në hartën e dhënë në pjesën e vijëzuar është paraqitur zona e okupuar e Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore nga:

- A. Austro-hungarezët
- B. Francezët
- C. Italianët
- D. Ruso-Turkët



77. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore, SHBA-të shpallën neutralitetin. Çka solli inkuadrimi i SHBA-ve në anën e Antantës në fund të luftës?

- A. Parakushtet për fillimin e revolucionit të Tetorit
- B. Parakushtet për disfatën e fuqive qendrore
- C. Parakushtet për hapjen e Frontit Lindor
- D. Parakushtet për hapjen e Frontit Jugor

78. Cilat nga vendimet e Kongresit të Vjenës të vitit 1815 u jetesuan?

- A. Kthimi i familjeve të vjetra mbretërore në fron dhe rivendosja e sistemit feudal
- B. Kthimi i Napoleon Bonapartës në fron dhe rivendosjen e sistemit feudal
- C. Krijimi i Austro-hungarisë dhe bashkimi i Italisë
- D. Krijimi i Perandorisë së Shenjtë Gjermane

GJEOGRAFI

79. Cili liqe natyral në trojet etnike është më i thelli?


- A. Liqeni i Shkodrës
- B. Liqeni i Ohrit
- C. Liqeni i Prespës
- D. Liqeni i Butrintit

80. Stalagmitet janë :

- A. forma erozive fluviale
- B. forma akumulative eolike
- C. forma akumulative krasike
- D. forma erozive eolike

81. Cila nga format e krijuara me shkarje (lëvizje tektonike) është paraqitur në figurë?

- A. Shkallëzimi tektonik
- B. Horsti
- C. Fleksura
- D. Grabeni



82. Sipas llojit të produkteve ose shërbimeve, veprimtaritë ekonomike ndahen në tre sektorë (primarë, sekondarë dhe terciarë).

Cila nga veprimtaritë hyn në sektorin tretësor (terciar)?

- A. Kultura, xehetaria, hoteleria, industria.
- B. Sigurimi, xehetaria, turizmi, industria.
- C. Arsimi, kultura, shëndetësia, tregtia.
- D. Shëndetësia, ndërtimtaria , arsimi, industria.

83. Në morfologjinë e relievit, malet janë element kryesor gjeografik i natyrës së trojeve shqiptare.

Cili nga pohimet është i saktë për Alpet Shqiptare, si pjesë e kësaj morfologjie?

- A. Alpet Shqiptare janë male të reja, me lartësi të madhe mbidetare dhe shkëmbinj gëlqeror-dollomitor
- B. Alpet Shqiptare janë male të vjetra, me lartësi të madhe mbidetare dhe shkëmbinj gëlqeror-dollomitor
- C. Alpet Shqiptare janë male të reja, me lartësi të vogël mbidetare dhe shkëmbinj kristalor
- D. Alpet Shqiptare janë male të vjetra, me lartësi mesatare mbidetare dhe shkëmbinj sedimentarë

84. Pse rrethi polar është më i shkurtër sesa rrethi tropik?

- A. Sepse është më afër ekuatorit
- B. Sepse është meridian fillestar
- C. Sepse është më afër pikës polare
- D. Sepse është meridian ndihmës

85. Për çfarë arsye erërat monsunë në Azinë Jugore dimrit fryjnë prej tokës (kontinentit) në drejtim të oqeanit?

- A. Dimrit ajri është më i ftohtë dhe shtypja më e lartë në tokë sesa në dete
- B. Dimrit ajri është më i nxehtë dhe shtypja më e lartë në tokë sesa në dete
- C. Dimrit ajri është më i nxehtë dhe shtypja më e ulët në tokë sesa në dete
- D. Dimrit ajri është më i ftohtë dhe shtypja më e ulët në tokë sesa në dete

86. Si procedon metoda induktive?

- A. Nga e veçanta në të veçantën
- B. Nga e përveçmja në të përgjithshmen
- C. Nga e përgjithshmja në të veçantën
- D. Nga e përgjithshmja në të përgjithshmen

87. Çfarë do të thotë akuza e Hajdegerit ndaj metafizikës tradicionale që ai e shpreh me nocionin “Harresa e qenies”?

- A. Se metafizika tradicionale i ka kushtuar rëndësi vetëm raportit mes qenies dhe të qenit e jo vetë qenies
- B. Se qenia mund të harrojë lehtë qeniet tjera përreth
- C. Se qenia si qenie nuk duhet të harrojë Zotin dhe raportin mes njeriut dhe Zotit
- D. Se njeriu nuk duhet të harrojë se ai është i krijuar nga një qenie e gjithëdijshme dhe e gjithëpushtetshme

88. Të supozojmë se personi A, i cili është 18-vjeçar, është duke shkuar në diskotekë vetëm për t’u dëfryer dhe për t’u kënaqur me shoqërinë e tij, por babai i tij nuk e lejon atë të shkojë atje, për shkak të konservativizmit të tij ose për shkak të bindjes se në diskoteka shprehet kënaqësia në mënyrë të tepruar. Si është duke vepruar prindi i personit A sipas utilitaristëve?

- A. Babai i personit A vepron në mënyrë të gabuar, kur ia ndalon atij të shkojë pas kënaqësisë në diskotekë, sepse vlen parimi se ai njeri që shkon pas kënaqësisë së tij, nuk ka kurrfarë kuptimi të thuhet se ai duhet të bëjë diçka tjetër
- B. Babai i personit A vepron në mënyrë të drejtë kur ia ndalon atij të shkojë në diskotekë
- C. Babai i personit A duhet t’ia ndalojë personit A me çdo kusht shkuarjen nëpër vendet e tilla, sepse ato vende e prishin rininë
- D. Babai i personit A ka të drejtë të ndërhyjë edhe me dhunë ose ta thërrasë policinë për ta prangosur personin A, nëse ai nuk e zbaton ndalesën e babait të tij për të mos shkuar në diskotekë

89. Në konkludimin ose argumentin e dhënë :

1. *Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm.*
2. *Sokrati është njeri.*

III.Pra, Sokrati është i vdekshëm

ku e gjejmë konkluzionin në argumentin e dhënë?

- A. Në gjykimet I dhe II
- B. Në gjykimet II dhe III
- C. Vetëm në gjykimin I
- D. Vetëm në gjykimin III

90. Cili nga gjykimet e mëposhtme paraqet pikëpamjen estetike subjektivistë?

- A. Subjekti njohës nuk e përcakton të bukurën, ajo përcaktohet nga një forcë mbinatyrore.
- B. E bukura nuk ekziston në objekte, por brenda subjektit.
- C. E bukura ekziston jashtë subjektit si diçka objektive.
- D. Ekzistenca e bukurisë së objekteve varet nga Zoti dhe nuk përcaktohet nga njeriu.

PSIKOLOGJI

- 91.** Ndryshimet e sjelljes si rezultat i kalimit të kohës apo moshës i studion:
- A. Psikologjia eksperimentale
 - B. Psikologjia sociale
 - C. Psikologjia zhvillimore
 - D. Psikologjia fiziologjike
- 92.** Çka paraqet Inkibicioni Proaktiv ose frenimi paravajtës, si një prej shkaqeve të harresës?
- A. Pengesën apo harresën që mësimi i tashëm i shkakton te vjetrit.
 - B. Pengesën apo harresën që mësimi i vjetër i shkakton te tashmit.
 - C. Pengesën apo harresën që ndodh për shkak të mospërdorimit
 - D. Pengesën apo harresën që ndodh në mënyre spontane.
- 93.** Çka janë Stereotipat ?
- A. Sjellje negative ndaj një grupi dhe anëtarëve të tij
 - B. Besime të gabuara përgjithëse ndaj një grupi dhe anëtarëve të tij
 - C. Qëndrime negative të pajustificueshme ndaj një grupi dhe anëtarëve të tij
 - D. Qëndrime negative të justifikueshme ndaj një grupi dhe anëtarëve të tij
- 94.** Koeficienti intelektual është raporti ndërmjet moshës mendore të një personi me moshën e tij kronologjike; $KI = (MM/MK) \times 100$. Nëse moshja mendore e një fëmije është 6 vjeç dhe moshja e tij kronologjike është 8 vjeç atëherë KI është;
- A. 60
 - B. 65
 - C. 70
 - D. 75
- 95.** Psikologët e shkollës geshtaltiste përcaktuan parimet, të cilat i quajtën ligje në bazë të të cilave formohet tërësia perceptive.
Cili parim është paraqitur në figurë?
- A. Parimi i ngjashmërisë
 - B. Parimi i mbylljes
 - C. Parimi i afërsisë
 - D. Parimi i simetrisë



SOCIOLOGJI

- 96.** Familja në të cilën vendimet kryesore i merr mashkulli quhet:
- A. Matriarkat
 - B. Patriarkat
 - C. Poligami
 - D. Monogami
- 97.** Ogyst Kont në teorinë e tij, konsideronte se bota gjatë historisë së saj ka kaluar nëpër tri faza zhvillimi intelektual; faza teologjike, faza metafizike, faza pozitiviste. Çka e karakterizon fazën metafizike?
- A. Besimi në forcat e ndryshme abstrakte
 - B. Besimi në fuqitë mbinatyrore hyjnore
 - C. Besimi në shkencë
 - D. Besimi në individin
- 98.** Sektet janë:
- A. Organizata fetare zyrtare me qëndrim konformist ndaj sistemit shoqëror
 - B. Organizata fetare që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me shtetin
 - C. Organizata fetare jozyrtare dhe jo të integruara mirë në shoqëri
 - D. Organizata fetare jozyrtare me qëndrim konformist ndaj sistemit shoqëror
- 99.** Sipas sistemeve politike dallojmë tri modele të pushteteve?
- A. Autokraci, Oligarki, Demokraci
 - B. Autokraci, Monarki, Sovranitet
 - C. Demokraci, Tirani, Republikë
 - D. Demokraci, Popullzimi, Diktaturë
- 100.** Çfarë kanë të përbashkët klasat dhe kastat:
- A. Janë forma të asimilimit të popullatës
 - B. Janë të rregulluara me ligj
 - C. Janë të rregulluara me religjion
 - D. Janë forma të pabarazisë shoqërore